



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE**

Nr. 16/8 Prot.

Tiranë më 24/05/2023

V E N D I M

Nr. 1 Datë 24/05/2023

Trupa e vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Suela Bulku Kryesuese
Arben Sefaj Relator
Denisa Sina Anëtar

në datën 24/05/2023 mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit:

SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT:

Vehbi Qerim Bushati, me funksion Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

BAZA LIGJORE:

Ligji Nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”. i ndryshuar.

Rregullore nr.197 datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”

RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (në vazhdim AMP) është organi kompetent që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

2. Neni 6, pika 1, shkronjat (a), (b), (c), (ç), (d) të Ligjit Nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, përcakton fushën e ushtrimit të veprimtarisë së Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, duke përcaktuar fashën e subjekteve, që i nënshtrohen procesit të vlerësimit kalimtar nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore.

3. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore vlerëson punonjësit në pozicionet e mëposhtme:

a) drejtor dhe zëvendësdrejtor i përgjithshëm, drejtor departamenti, drejtor i drejtorisë qendrore, drejtor në strukturat e veçanta, drejtor e zëvendësdrejtor vendor, drejtor në drejtoritë e kufirit dhe migracionit, shef komisariati, shef sektori në nivel qendror e vendor, që mbulon fushën e krimit të organizuar, krimit ekonomik/financiar dhe policisë rrugore në Policinë e Shtetit;

b) drejtor dhe zëvendësdrejtor i përgjithshëm, drejtor drejtorie dhe shef njësie në Gardën e Republikës;

c) drejtor dhe zëvendësdrejtor i përgjithshëm, drejtor drejtorie, shef sektori në nivel qendror dhe vendor në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore;

ç) punonjësit që do të emërohen në strukturën e vlerësimit kalimtar/periodik në AMP;

d) çdo punonjës që emërohet në pozicionet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “d”, të pikës 1, të këtij neni bëhet subjekt i vlerësimit.

4. Me shkresën nr. *** prot datë 13.03.2023, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është vënë në dijeni nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, se në zbatim të ligjit 12/2018 i ndryshuar, janë marrë në dorëzim nga strukturat e burimeve njerëzore, sipas afateve të përcaktuara dokumentacionet e disa prej subjekteve, punonjës të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, ndër të cilët edhe subjekti z.Vehbi Bushati.

5. Më datë 05.04.2023 nga AMP në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr. 7 datë 17.01.2023 “Për procedurat e mënyrën e hedhjes së shortit për Trupat e Vlerësimit dhe subjektet e Vlerësimit të Ligjit Nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar, u hodh shorti për ndarjen e trupave vlerësuese, shpërndarjen e çështjeve në trupat e vlerësimit, si edhe caktimin e anëtarit relator.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën nr.*** prot datë 12.04.2023, ka depozituar pranë AMP formularët për subjektet e vlerësimit, ku rezulton të jetë depozituar dhe dosja e subjektit të vlerësimit Z.Bushati.

7. Më datë 18.04.2023 në respektim të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, anëtarët e trupës së vlerësimit të përbërë nga Suela Bulku Kryesues, Arben Sefaj Relator dhe Denisa Sina Anëtare, kanë deklaruar se nuk janë në konflikt interesi me subjektin e vlerësimit z. Vehbi Bushati.

8. Në datën 19.04.2023, relatori i çështjes me anë të postës elektronike zyrtare, në përputhje me Ligjin nr.12/2018, të ndryshuar, ka njohur subjektin e vlerësimit z.Vehbi Bushati me anëtarët e Trupës së Vlerësimit dhe i ka kërkuar subjektit të vlerësimit deklarimin e konfliktit të interesit me anëtarët e Trupës Vlerësuese.

9. Me anë të komunikimit elektronik zyrtar të datës 26.04.2023, subjekti i vlerësimit ka deklaruar se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.

10. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dosjen e subjektit të vlerësimit z. Vehbi Bushati me detyrë Drejtor i Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, relatori i çështjes parashtrori faktet dhe rrethanat si më poshtë:

- Me shkresën nr.*** datë 10.03.2023, Vërtetim i Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë z.Vehbi Bushati ka dorëzuar:
 - formularët e deklarimit për kontrollim e figurës për vlerësimin kalimtar dhe periodik me numër faqesh: **S’ka**
 - formularët e vlerësimit të aftësive profesionale për vlerësimin kalimtar dhe periodik me numër faqesh: **S’ka**
 - formularët e vlerësimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik me numër faqesh: **S’ka**
 - dokumenta shoqërues që vërtetojnë vërtetësinë e deklarimeve me numër faqesh: **S’ka**
 - Subjekti i vlerësimit me shkresën nr.*** datë 04.05.2018, Vërtetim i Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, Drejtues z. Vehbi Bushati me Funkcion Drejtor në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, ka dorëzuar në sektorin e personelit të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër dokumentacionin si më poshtë:
 - Deklaratë e Pasurisë, fletë 30 (tridhjetë)
 - Deklaratë për Kontrollin e Figurës, fletë 16 (gjashtëmbëdhjetë)
 - Formulari i Vetëvlerësimit Profesional, fletë 9 (nëntë)
 - Dokumenta shoqërues që vërtetojnë vërtetësinë e deklarimeve, fletë 106 (njëqind e gjashtë)
- ✓ Deklarata e Pasurisë mban Nr. Indeksi *** viti 2018

- ✓ Deklarata për Kontrollin e Figurës mban datën 04.05.2018
- ✓ Formulari i Vetëvlerësimit Profesional mban datën 05.05.2018
- ✓ Deklaratë e Interesave Private Periodike/Vjetore format për ILDKPKI me numër Indeksi ***/2022 dorëzuar në ILDKPKI më datë 31.03.2023

ARSYETIMI LIGJOR I TRUPËS SË VLERËSIMIT PRANË AMP

11. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e subjektit të vlerësimit, në bazë të ligjit Nr. 12/2018 të ndryshuar, neni 32, pika 2, *“Punonjësi plotëson deklaratën e pasurisë, sipas përcaktimit të bërë në pikën 1, të këtij neni, brenda 30 ditëve, nga hyrja në fuqi e udhëzimit të Ministrit të Brendshëm dhe e dorëzon në njësinë e burimeve njerëzore të institucionit ku punon”*, si dhe nga vërtetimi i burimeve njerëzore që mban datën 10.03.2023, **rezultoi se nuk janë dorëzuar formularët e deklarimit të pasurisë.**

12. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e subjektit të vlerësimit, në bazë të ligjit Nr. 12/2018 të ndryshuar, neni 36, pika 1, *“Punonjësi plotëson deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës nr.2, bashkëlidhur këtij ligji dhe e dorëzon atë brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e udhëzimit të Ministrit të Brendshëm në njësinë e burimeve njerëzore të institucionit ku punon”*, si dhe nga vërtetimi i burimeve njerëzore që mban datën 10.03.2023, **rezultoi se nuk është dorëzuar deklarata e Kontrollit të Figurës.**

13. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e subjektit të vlerësimit, në bazë të ligjit Nr. 12/2018 të ndryshuar, neni 44, pika 1, *“Punonjësi plotëson formularin e vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij ligji dhe brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e udhëzimit të Ministrit të Brendshëm e dërgon pranë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit ku punon”*, si dhe nga vërtetimi i burimeve njerëzore që mban datën 10.03.2023, **rezultoi se nuk është dorëzuar formulari vlerësimit të Aftësive Profesionale.**

14. Referuar dokumentacionit në dosjen e subjektit të vlerësimit z.Vehbi Bushati, Trupa Vlerësuese konstaton se në bazë të ligjit Nr. 12/2018, të ndryshuar, si edhe në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe ILDKPKI, Nr. 15, datë 27.01.2023 *“Për miratimin e formularëve të deklarimit të Pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” (i ndryshuar)*, formularët e deklaratës së pasurisë, të deklaruara në dosjen e subjektit, **nuk janë formularët tip sipas shtojcës 1 të miratuar në udhëzimin e cituar në këtë paragraf si dhe formulari i dorëzuar pranë AMP është më datë 04.05.2018.**

Trupa e Vlerësimit konstaton se: Nuk është zbatuar ligji Nr. 12/2018 i ndryshuar dhe Udhëzimi i përbashkët nr.15 datë 27.01.2023 i Ministrit të Brendshëm dhe ILDKPKI.

15. Referuar dokumentacionit në dosjen e subjektit të vlerësimit z.Vehbi Bushati, Trupa Vlerësuese konstaton se në bazë të ligjit Nr. 12/2018 të ndryshuar si edhe në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr. 6 datë 17.01.2023 *“Për miratimin e formularëve të deklarimit të*

kontrollit të Figurës dhe Vlerësimit të Aftësive Profesionale për Vlerësimin kalimtar dhe periodik, si edhe mënyrën e plotësimit të tyre në zbatim të ligjit Nr. 12/2018 “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” (i ndryshuar), formulari i deklaratës për kontrollin e figurës, i deklaruar në dosjen e subjektit, **nuk është formulari tip, Shtojca 1, i miratuar sipas udhëzimit të cituar në këtë paragraf dhe data e deklarimit është 04.05.2018.**

Trupa e Vlerësimit konstaton se: Nuk është zbatuar ligji Nr. 12/2018 i ndryshuar dhe Udhëzimi i Ministrisë të Brendshme nr.6 datë 17.01.2023.

16. Referuar dokumentacionit në dosjen e subjektit të vlerësimit z.Vehbi Bushati, Trupa Vlerësuese konstaton se në bazë të ligjit Nr. 12/2018 të ndryshuar si edhe në Udhëzimin e Ministrisë të Brendshme Nr. 6 datë 17.01.2023 “Për miratimin e formularëve të deklarimit të kontrollit të Figurës dhe Vlerësimit të Aftësive Profesionale për Vlerësimin kalimtar dhe periodik, si edhe mënyrën e plotësimit të tyre në zbatim të ligjit Nr. 12/2018 “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” (i ndryshuar), formulari i vlerësimit të aftësive profesionale, e deklaruar në dosjen e subjektit, **nuk është formulari tip, Shtojca 2, i miratuar sipas udhëzimit të cituar në këtë paragraf dhe data e deklarimit është 05.05.2018.**

Trupa e Vlerësimit konstaton se: Nuk është zbatuar ligji Nr. 12/2018 i ndryshuar dhe Udhëzimi i Ministrisë të Brendshme nr.6 datë 17.01.2023.

17. Z. Bushati ka dorëzuar deklaratën e Interesave Private Periodike/Vjetor me Nr. Indeksi ***/2022 datë 31.03.2023. Format i deklaruar nuk është format i miratuar në Udhëzimin e përbashkët Nr.15, datë 27.01.2023, i Ministrisë të Brendshme dhe ILDKPKI, Shtojca 1.1 “Deklarata e pasurisë për vlerësimin periodik”.

18. Deklarata e Interesave Private Periodik/Vjetor e deklaruar nga subjekti është format për ILDKPKI ku subjekti deklaroi interesat e tij private pasi për shkak të pozicionit që mban aktualisht është subjekt i ligjit Nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

Pavarësisht për sa më sipër, z. Bushati është subjekt i vlerësimit kalimtar dhe jo i vlerësimit periodik.

19. Trupa e vlerësimit pranë AMP-së, nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosje, konkretisht të Vërtetimit Nr.*** prot. datë 10.03.2023, konstaton se subjekti i vlerësimit **nuk ka dorëzuar** formularët e deklarimit të miratuar për procesin e vlerësimit kalimtar pranë, sektorit të burimeve njerëzore dhe trajnimeve të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë.

Marrësi në dorëzim, nuk ka plotësuar në mënyrë të plotë dhe të saktë vërtetimin për marrjen e formularëve të deklarimit dhe dokumentacionit shoqërues, sipas nenit 32 pika 4, nenit 36 pika 2 dhe nenit 44 pika 1, ku “njësitë e burimeve njerëzore kanë detyrim që këto formularë t’i pranojnë dhe t’i vendosin në dosjen e çelur për punonjësin”.

20. Në mbledhjen e datës 12.05.2023, Trupa e Vlerësimit pasi mori në shqyrtim të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga Z. Bushati, krijoi bindjen se provat e administruara kanë nivelin e provueshmërisë, vendosi mosçeljen e hetimit administrativ dhe zbardhjen e vendimit përfundimtar.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara në dosjen e subjektit të vlerësimit, Z. Vehbi Bushati, në zbatim të ligjit Nr. 12/2018 të ndryshuar neni 32 pika 3, neni 36 pika 1.1, neni 44 pika 1.1, Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe ILDKPKI nr. 15 datë 27.01.2023 “Për miratimin e formularëve të deklaramit të pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr. 6 datë 17.01.2023 “Për miratimin e formularëve të deklaramit të kontrollit të Figurës dhe Vlerësimit të Aftësive Profesionale për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik, si dhe mënyrën e plotësimit të tyre në zbatim të ligjit Nr. 12/2018 “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” (i ndryshuar), arrin në përfundimin se:

- **Subjekti i Vlerësimit Z. Vehbi Bushati me detyrë Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë nuk ka plotësuar dhe dorëzuar formularët e deklaramit të Pasurisë, deklaratën e Kontrollit të Figurës dhe formularin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale;**

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë Mbikëqyrjes Policore, bazuar në nenin 32, pika 3, nenin 36 pika 1.1, nenin 44 pika 1.1, të ligjit nr.12/2018 "Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme", i ndryshuar,

V E N D O S I

1. Largimin nga pozicionet e përcaktuara në nenin 6 të ligjit 12/2018, i ndryshuar, të subjektit të vlerësimit, z.Vehbi Bushati me detyrë Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet Subjektit të Vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.

3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall sot më datë 24/05/2023, në Tiranë.

TRUPA E VLERËSIMIT

Suela Bulku

Kryesues

Arben Sefaj

Relator

Denisa Sina

Anëtar